



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:172488

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05718909

**AC.nr.6620/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**, në kolegjin gjyqësor të përbërë nga gjyqtarët: Besnik Feka kryetar i kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Besnik Bislimaj anëtarë të kolegjit në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: B.K. e S., me seli në P., xxxxx ., të cilën e përfaqëson, Kompania “D. L. R. SH.P.K” me seli ne P., me përfaqësuesin te autorizuar G. Z. me autorizim pranë te njëjtës, kundër të paditurit: A. A. nga fshati S. Komuna e I, për rimbursimin e dëmit, vlera e kontestit: 1.669,00 Euro, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.351/19, të datës 30.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë:20.05.2024, nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.REFUZOHET SI E PA BAZUAR** ankesa e të paditurit A. A. nga fshati S./Komuna e I, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.351/19, dt: 29.06.2021, në pikën **I** dhe **III** të dispozitivit të tij, **VËRTETOHET**.

**II.Pika II** e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.351/19, dt: 29.06.2021, **ngel e pa shqyrtuar**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore Pejë-Dega në Istog, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e ankimuar e ankimuar C.nr. 351/19, datës 29.06.2021, ka vendosur si në vijim:

**APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR**, kërkesë padia e paditëses: B. K. e S.“BKS”, adresa xxxxx, P..

**I. DETYROHET** i padituri: A. A., nga fshati S., Komuna e I, që paditëses në emër të rimbursimin të dëmit, për aksidentin e dt. 12.10.2017, sipas bazës së autopërgjegjësisë, për 70%, të përgjegjësisë, t’i paguaj shumën në lartësi prej: 1,168.30 euro, me kamatë ligjore prej 8%,

duke filluar nga dt. 29.06.2021, e deri në pagesën definitive në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi në dorëzim e nen kërcenim të përbarimit ligjor.

**II. REFUZOHET Pjesërisht se e pa bazuar** kërkesë padia e paditëses: B.K. e S. “BKS”, adresa xxx, P. , përtej shumës së gjykuar, si në pikën I, në dispozitivin e këtij aktgjykimi që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit, për aksidentin e dt. 12.10.2017, sipas bazës së autopërgjegjësisë, t’i paguaj shumën në lartësi prej: 500.70 euro.

**III. Detyrohet** i padituri të ia paguajë shpenzimet e procedurës paditëses në shumën prej 190 euro, në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi në dorëzim e nen kërcenim të përbarimit ligjor.

Kundër aktgjykimit të lartpërmendur, brenda afatit të përcaktuar ligjor ankesë ka ushtruar i padituri A. A. nga fshati S./Komuna e I.për shkak të shkeljes të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të të drejtës materiale, dhe duke marrë parasysh interesin juridik të parashtruesit të ankesës, konsiderohet se aktgjykimin e ka goditur pjesërisht dhe atë vetëm sa i përket pikës I dhe III të dispozitivit të tij (pjesës aprovuese të kërkesëpadisë), me propozim që gjykata e shkallës dytë aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj në pikat e atakuara me ankesë dhe refuzoj kërkesëpadinë e paditëses, apo të njëjtin aktgjykim ta prish dhe lëndën t’a kthejë në rigjykim në shkallë të parë.

Përgjigje në ankesë nuk është ushtruar nga paditësja.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit dhe analizimit të provave në shkresat e lëndës, në bazë të nenit 194, 195, par.1, pika (d), në lidhje me nenin 200 të LPK-së, gjeti se:

**Ankesa e të paditurit A. A. nga fshati S./Komuna e I., është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësja B. K. e S. (BKS) me seli në P., ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore Pejë-Dega në Istog, me datë 09.08.2019, kundër të paditurit A. A. nga fshati S./Komuna e I., për shkak të rimbursimit të dëmit, vlera e kontestit 1,669 €.

I padituri me përgjigje në padi, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetem në tersi pranë deklaramëve të bëra në seanca paraprakë, duke shtuar se unë nuk jam shkaktar për këtë aksident ata kanë shkaktuar vet këtë aksident për shkak të shpejtësisë së madhe, dhe me fajin e tyre mua me kanë lenë fajtorë, unë nuk jam fajtor, gjykatës i propozoj që të refuzoj padinë e paditëse sepse unë nuk kam qenë fajtor në këtë aksident

Gjykata e shkallës së parë, pas pranimit të përgjigjes në padi, shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka nxjerr aktgjykimin e ankimuar me vendosje më të hollësishme si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në përmbajtjen e arsytimit lidhur me mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga leximi i ekspertizës të datës 23.02.2021, e përpiluar nga eksperti i komunikacionit Dr. Sc. Sejdi Berisha, gjykata e ka vërtetuar rrethanën se i padituri A. A., është përgjegjës për shkaktimin e aksidentit të datës, 12.10.2017. Nga përfundimi i ekspertizës dhe analiza e aksidentit, është dhënë përfundimi se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e asaj se traktori “A” gjatë kyçës në udhëkryq e ka penguar automjetin “B” i cili ka qenë në shiritin e tij të lëvizjes në rrugën kryesore, ky ngasësi “A” pa u bindur me parë se nuk e rrezikon ose nuk i

pengon pjesëmarrësit të tjerë në trafik ka marrë veprimin e pasigurte dhe e ka shkaktuar aksidentin. Ngasësi “A” ka pas mundësi të perceptoj ardhjen e automjetit “B” por e ka neglizhuar rrezikun. Duke analizuar rrjedhjen e aksidentit gjurmët dhe demet e shkaktuara përmes metodës Rastër rezulton se ngasësi i automjetit “B” ka lëvizur me shpejtësi rreth 75 (km/h) në zonën e kufizuar 50(km/h), shpejtësi jo adekuate konform shenjave. Ngasësi i automjetit “B” nuk ka kontribuar në shkaktimit e aksidentit por me këtë shpejtësi të lëvizjes ka kontribuar në rritjen e vëllimit të dëmeve.

Nga ujdia jashtë gjyqësore e datës: 06.12.2018, e cila gjendet në shkresat e lëndes gjykata konstaton se të dëmtuarit F. e S. të K. në këtë aksident, kanë lidhur ujdë jashtëgjyqësore me B. K. të S. - këtu paditësen, për kompensimin e dëmit material në shumën që përfshin totalin në lartësi prej, 470.00 Euro.

Nga Dokumenti Transferim me numër bankar, gjykata konstaton se B. K. e S., ka bërë pagesën e detyrimit sipas ujdise jashtëgjyqësore në llogarinë bankare të të dëmtuarës që janë përfshirë në aksident respektivisht të autorizuarit të tyre.

Përgjegjësia 70% e të paditurit konsiston në faktin se i padituri A. A. në cilësinë e drejtuesit të mjetit traktor xxx, kishte shkaktuar aksident dhe se nga përfundimi i ekspertizës dhe analiza e aksidentit, është dhënë përfundimi së aksidenti ka ardhur në kryqëzimit të rrugës Istog – Dubravë, në rrugën e fshati S., dhe duke u bazuar nga materialet në lëndë, analizën dhe konstatimet e mësipërme, mendojmë se aksidenti është shkaktuar nga veprimi i drejtuesit të automjetit IMT 539: në baze të asaj deri të aksidenti ka ardhur si pasojë e pasigurt në rrugën me përparësi kalimi. Dhe nga e cekura është shkaktuar dëme material, ku kontribut në aksident ka dhen edhe drejtuesi i automjeti Toyota 4 Runner për shkak të lëvizjes me të madhe se ajo e lejuar, respektivisht kishte dhen kontribut sekondar.

Përgjegjësia për 30%, e drejtuesi të automjetit “B” ka qarkulluar me shpejtësinë e lëvizjes rreth 75 km/h në zonën e kufizuar 50 km/h, shpejtësi jo adekuate konform shenjave, rregullave dhe rrethanave të krijuara në komunikacion.

Baza juridike e kërkesë padisë, që i padituri të jetë përgjegjëse për rimbursimin e dëmit paditëses gjejnë mbështetje në dispozitat e Ligjit për Sigurimet e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia Nr. 04/L-018, e lidhur me dispozitat e nenit 262.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Paditësja është dashur ta kompensojë dëmin të dëmtuarit në aksidentin e komunikacionit rrugor të dt.12.10.2017, në bazë të dispozitës Ligjit për Sigurimet e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia Nr. 04/L-018, të Auto-përgjegjësive në të cilën shprehimisht parashihet së në rast të dëmit të shkaktuar si pasojë e përdorimit të automjetit, ku pronari është dashur por nuk ka kontraktuar Sigurimin e Detyruar të Auto përgjegjësive – zhvendimi paguhet deri në të njëjtën shumë dhe sipas të njëjtave kushte sikur të ekzistonte Sigurimi i Detyrueshëm e Auto-përgjegjësive nga Fondi i Garantues së Kosovës, në bazë të dispozitës të Ligjit për Sigurimet e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia Nr. 04/L-018.

Meqenëse paditësja në bazë të provave prezent në shkresat të lëndës ka përmbushur detyrimin ndaj të dëmtuarve si pasojë e këtij aksidenti ka të drejtë që të kërkojë rimbursimin e shumës së paguaj në bazë të nenit 18 të Ligjit për Sigurimet e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia Nr. 04/L-018, e cila shprehimisht “ *Byroja ka të drejtë regresive për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat*”.

Sipas dispozitës së nenit 7, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK, secila palë ndërgjyqës, ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Meqenëse i padituri me asnjë provë të vetme, nuk e ka argumentuar të kundërtën e dëmit të pretenduar, andaj gjykata e vënë para një situatë të tillë dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi juridik – civil, ndaj paditëses për rimbursimin e dëmit, në shumën prej: 1.168,30 euro, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit: 262 paragraf 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet të Detyrimeve, i cili shprehimisht parasheh se kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve, është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbush detyrimin me ndërgjegje dhe në tërësi sikur është përmbajtja e tij, dhe si rezultat i kësaj paditësjë ka paguar në tërësi dëmin që e ka shkaktuar i padituri, me ç’ rast i padituri ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësen, në të cilin raport paditësjë e ka cilësinë e kreditorit kurse i padituri e ka cilësinë e debitorit.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 186 dhe 277 të LMD-së, për arsye se i padituri ka mësuar-ka ra në vonesë për detyrimin-rimbursimin e dëmit të shkaktuar nga data e vendosjes nga gjykata.

Vendimin që pala e paditur ti bart shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë, lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve të palës paditëse dhe atë: 30 euro në emër të taksës gjyqësore për padi dhe në emër të ekspertizës nga lemija e komunikacionit shumën prej 150 euro.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por as me shkelje të cilat pretendohen me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor, dhe se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe plotësisht ka vërtetuar gjendjen faktike dhe përgjegjësinë e ndarë të paditësit në aksidentin e komunikacionit të datës 12.10.2017 në Istog, dhe atë nga konstatimi i ekspertizës së ekspertit të komunikacionit ka rezultuar se i padituri A. A.mban përgjegjësi për aksidentin e komunikacionit në shkallë prej 70%, dhe duke iu referuar shkresave të lëndës, konstatohet se paditësjë në procedurë administrative ka rimbursuar dëmin në shumën totale prej 1,856 euro, ndërsa duke marrë për bazë përgjegjësinë e ndarë në rastin konkret gjykata e shkallës së parë duke zbritur shumën prej shumës së kërkuar nga paditësjë 1,669 euro, drejtë ka detyruar të paditurin në shumën e gjykuar prej 1,168.30 euro, ngase duke iu referuar shkallës së përgjegjësisë prej 70%, në mbështetje të nenit 18 par.4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia nr. 04/L-118, ku përcaktohet e drejta e paditëses për rimbursimin e dëmit nga personat përgjegjës në rastin konkret nga paditësi duke iu referuar shkallës së saj të përgjegjësisë prej 70%, në lidhje me nenin 262 paragraf 1, të Ligjit mbi

Marrëdhëniet të Detyrimeve nr. 04/L-077, i cili shprehimisht parasheh se kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve, është i autorizuar që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbush detyrimin me ndërgjegje dhe në tërësi sikur është përmbajtja e tij, në rastin konkret i padituri duhet të përmbushë detyrimin e tij lidhur me rimbursimin e dëmit në shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me kamatëvonesën e gjykuar në shkallë prej 8% vjetore është vendosje e drejtë ngase në rastin konkret edhe pse e njëjta është vendosur nga data e nxjerrjes së aktgjykimit në shkallë të parë, duke marrë për bazë interesin juridik të ankuesit, në rastin konkret e njëjta nuk mund të ndryshohet në dëm të palës ankuese, prandaj, në kuptim të nenit 382 të LMD-së, vendosja nga gjykata e shkallës së parë është e drejtë dhe në përputhje me ligjin.

Gjithashtu, edhe vendosja e shpenzimeve të procedurës është në përputhje me nenin 452, par.2 të LPK-së, ashtu që, pavarësisht aprovimit të pjesërishëm të kërkesëpadisë, shpenzimet e shkaktuara kanë qenë të domosdoshme në vërtetimin e drejtë dhe plotë të gjendjes faktike nga e cila ka rezultuar themelësia e pjesërishme e kërkesëpadisë së paditëses.

Meqë, pika II e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar nuk është atakuar nga pala me interes juridik për parashtrimin e ankesës, duke iu përmbajtur kufizimeve ligjore nga neni 194 i LPK-së (kufinj të ekzaminimit të ankesës), si dhe neni 203 të LPK-së, gjykata këtë pikë të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar nuk e shqyrtoi fare.

Prandaj, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), në lidhje me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË**  
**AC.nr.6620/2021 me datë 20.05.2024**

**Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari**  
**Besnik Feka**